



YouTube publikoi sot zyrtarisht ndryshimet e reja në grafikën dhe strukturën e saj. Tashmë YouTube ka një faqe tërësisht të dizajnuar, me ngjyra dhe lehtësira për përdoruesit e saj. Pamjet e para të grafikës së re të YouTube ishin publikuar gjatë muajit korrik të këtij viti, kur Google ishte duke testuar dizajnin e ri.

Google bëri të ditur se pamja e re e faqes ka për qëllim që t'u mundësojë përdoruesve të fokusohen dhe të zbulojnë përmbajtjen e tyre të preferuar në YouTube. "Ne gjithmonë jemi në kërkim të inovacionit dhe ndryshimit, i cili do të sjellë gjëra më të mira për përdoruesit"- theksohet në njoftimin zyrtar të Google./balkanweb/